Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 14 mars 2013

Lënda nr. 31/08

Marija LALIÇ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 14 mars 2013,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Znj. Christine CHINKIN
Znj. Françoise TULKENS

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u paraqit më 18 korrik 2008 dhe u regjistrua në të njëjtën ditë.

2. Më 23 tetor 2008, Paneli ia komunikoi rastin Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) për komentet e UNMIK-ut mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e rastit. Më 11 nëntor 2008, PSSP-ja ofroi përgjigjen e UNMIK-ut.

3. Më 17 nëntor 2008, Paneli kërkoi informacione shtesë nga ankuesja. Paneli mori përgjigjet e ankueses më 15 dhjetor 2008 dhe më 16 janar 2009.

4. Më 24 shtator 2009, pas marrjes së informacioneve shtesë nga ankuesja, Paneli ia rikomunikoi rastin PSSP-së për komentet e UNMIK-ut mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e rastit. Më 15 tetor 2009, PSSP-ja e ofroi përgjigjen e UNMIK-ut.

5. Më 10 nëntor 2010, Paneli kërkoi sqarime shtesë nga ankuesja. Përgjigjja e ankueses u pranua më 18 nëntor 2010.

6. Më 31 janar 2011, Paneli kërkoi informacione nga gjykata e qarkut të Prishtinës. Lidhur me këtë kërkesë nuk është marrë asnjë përgjigje.

7. Më 3 maj 2011, Paneli e përsëriti kërkesën e tij për informacione shtesë drejtuar gjykatës së qarkut në Prishtinë. Përgjigjja e gjykatës së qarkut u pranua më 5 maj 2011.

8. Më 20 korrik 2011, Paneli kërkoi informacione lidhur me këtë rast nga gjykata komunale e Prishtinës. Gjykata komunale e ofroi përgjigjen e saj më 4 shtator 2011.

9. Më 6 dhjetor 2011, Paneli kërkoi informacione shtesë nga gjykatat komunale të Prishtinës dhe Lipjanit. Paneli mori përgjigjet e gjykatës komunale të Prishtinës dhe gjykatës komunale të Lipjanit më 12 dhjetor përkatësisht 14 dhjetor 2011.

10. Më 6 mars 2012, Paneli mori informacione shtesë për ankesën nga gjykata e qarkut të Prishtinës.

11. Më 29 mars 2012, Paneli ia rikomunikoi rastin PSSP-së për komente mbi pranueshmërinë, pas marrjes së informacioneve plotësuese. Më 4 maj 2012, Paneli mori përgjigjen e UNMIK-ut.

12. Më 9 qershor 2012, Paneli e shpalli ankesën pjesërisht të pranueshme.

13. Më 13 qershor 2012, Paneli e informoi PSSP-në për vendimin dhe kërkoi komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e rastit. Më 16 korrik 2012, PSSP-ja ofroi përgjigjen e UNMIK-ut.

14. Më 13 nëntor 2012, Paneli mori informacione plotësuese lidhur me rastin nga gjykata e qarkut në Prishtinë.

II. FAKTET

15. Ankuesja është ish banore e Kosovës, e cila aktualisht jeton në Serbi. Ajo u largua nga Kosova më 12 qershor 1999 për shkaqe sigurie.

16. Ankuesja thekson se në vitin 1993 ajo paraqiti padi pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë për përcaktimin e atësisë kundër babait të pretenduar të vajzës së saj, e cila kishte lindur në vitin 1991. Më 17 dhjetor 1997, gjykata e sipërpërmendur, duke vepruar si gjykatë e shkallës së parë, mori vendim në favor të ankueses, duke e urdhëruar të paditurin të paguaj kompensim mujor për kujdesin dhe edukimin e fëmijës.

17. Në një datë të papërcaktuar, i padituri parashtroi ankesë kundër këtij vendimi të gjykatës së qarkut. Më 22 tetor 1998, Gjykata Supreme e Serbisë, si gjykatë e apelit e ktheu mbrapsht vendimin e gjykatës së qarkut dhe çështjen ia referoi gjykatës komunale të Prishtinës për rigjykim.

18. Ankuesja thekson se pavarësisht nga ky vendim i Gjykatës Supreme të Serbisë, rigjykimi nuk u bë. Ajo gjithashtu thekson se përfaqësuesi i saj ligjor ka kërkuar nga autoritetet gjyqësore, disa herë, duke përfshirë edhe kohën pas ardhjes së UNMIK-ut në Kosovë në qershor të vitit 1999, që të përshpejtojnë rastin e saj, por kjo nuk pati sukses. Mirëpo, ajo nuk siguron dokumentacion lidhur me këtë kërkesë.

19. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

20. Më 11 maj 2011 përkatësisht më 4 shtator 2011, gjykata e qarkut dhe gjykata komunale e Prishtinës e njoftuan Panelin se ata nuk mund të gjenin shënime për ndonjë padi për përcaktimin e atësisë dhe ofrimin e kompensimit për fëmijën të parashtruar nga ankuesja.

21. Mirëpo, më 6 mars 2012, dosja origjinale e lëndës lidhur me padinë për përcaktimin e atësisë u gjend në arkivat e gjykatës së qarkut në Prishtinë. Sekretariati i Panelit pati mundësinë të kontrollojë dosjen dhe të merr pjesë relevante të saj, duke përfshirë edhe kopjen e vendimit të Gjykatës Supreme të datës 22 tetor 1998. Duket se dosjen e lëndës gjykata e qarkut asnjëherë nuk ja kishte dërguar gjykatës komunale të Prishtinës për rigjykim, ashtu siç ishte urdhëruar nga Gjykata Supreme.

22. Procedurat gjyqësore lidhur me padinë e ankueses për përcaktimin e atësisë nuk janë përfunduar deri më sot.

III. ANKESA

23. Përderisa ankesa është shpallur e pranueshme, ankuesja ankohet për siç pohon dështimin e procedurës gjyqësore në përcaktimin e atësisë ligjore të vajzës së saj, dhe prandaj ankohet edhe për mospërfundimin e procedurës së tillë brenda një periudhe kohore të arsyeshme. Ajo po ashtu ankohet se nuk ka pasur qasje në mjete efektive dhe se ajo, në ndërkohë, është dashur vet të sigurojë mjete jetese për përkujdesjen e fëmijës.

24. Paneli mendon se ankuesja mund të konsiderohet se thirret në shkelje të së drejtës së saj për qasje në gjykatë dhe kushtin për kohën e arsyeshme të garantuar me nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), dhe në shkelje të së drejtë së saj për mjet të efektshëm sipas nenit 13 të KEDNJ.

IV. LIGJI

A. Lidhur me faktet e çështjes dhe vlerësimin e dëshmive

Parashtresat e palëve

25. Ankuesja ankohet se procedurat gjyqësore për përcaktimin e atësisë ligjore të fëmijës së saj, të cilat u iniciuan pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë në vitin 1993, nuk janë përfunduar deri më sot. Ankuesja thekson se pasi Gjykata Supreme kishte urdhëruar rigjykim në vitin 1998, ajo kërkoi nga gjykatat kompetente disa herë, duke përfshirë edhe kohën pas ardhjes së UNMIK-ut në Kosovë, të rifillojë procedurën. Mirëpo nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim dhe asnjë vendim nuk është marrë deri më sot për kërkesën e saj.

26. Në komentet e tij të datës 16 korrik 2012, PSSP-ja argumenton se informacionet e grumbulluara nga Paneli në gjykatën e qarkut në Prishtinë, në takimin me administratorin e gjykatës, mund të jenë "indikative, por jo përfundimtare" lidhur me faktet e çështjes. Sipas PSSP-së, "akoma mbetet për t'u verifikuar nëse dosja lidhur me padinë e ankueses për përcaktimin e atësisë gjendet në gjykatën e qarkut dhe asnjëherë nuk është transferuar në gjykatën komunale". Sipas mendimit të PSSP-së, ka shumë gjasa që dosja të jetë humbur gjatë ngjarjeve të konfliktit të Kosovës, veçanërisht ndërmjet fundit të vitit 1998 dhe mesit të 1999.

Vlerësimi i Panelit

27. Sa i përket vërejtjes së PSSP-së se disa fakte të çështjes – veçanërisht nëse dosja lidhur me padinë e atësisë akoma ruhet në gjykatën e qarkut të Prishtinë dhe asnjëherë nuk është dërguar në gjykatën komunale – nuk janë të verifikuara në mënyrë të mjaftueshme, Paneli përkujton se, sipas nenit 15.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ka kompetenca të hetojë ankesat dhe të kërkojë paraqitjen e informacioneve dhe dokumentacionit nga UNMIK-u dhe nga palët e treta.

28. Paneli po ashtu i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas së cilës nuk ka barriera procedurale për pranimin e dëshmive apo formulës së parapërcaktuar për vlerësimin e dëshmive të mbledhura. Sipas praktikës së rrënjosur gjyqësore, provat mund të dalin nga bashkë-ekzistimi i konkluzioneve të fuqishme, të qarta dhe të pajtueshme apo nga supozimet e ngjashme të fakteve të hedhura poshtë (shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), *Nachova dhe të Tjerët kundër Bullgarisë*, nr. 43577/98 dhe 43579/98, aktgjykim i 6 korrikut 2005, § 147). Në pajtim me praktikën e Gjykatës Evropiane, Paneli miraton konkluzione të cilat, sipas mendimit të tij, janë të mbështetura me vlerësimin e lirë të të gjitha dëshmive, duke përfshirë edhe konkluzionet e tilla që mund të dalin nga faktet dhe nga parashtresat e palëve.

29. Në rastin aktual, Paneli kishte siguruar dëshmi nga zyrtarët e gjykatës se dosja origjinale e lëndës deri më 6 mars 2012 akoma mbahej në gjykatën e qarkut të Prishtinës, dhe se rasti asnjëherë nuk ishte dërguar në gjykatën komunale për rigjykim. Përveç kësaj, gjykata komunale e Prishtinës e informoi Panelin se ankesa asnjëherë nuk ishte regjistruar pranë kësaj gjykate për rigjykim. Në këto rrethana, dhe duke pasur parasysh faktin se UNMIK-u nuk paraqet ndonjë dëshmi që tregon të kundërtën, Paneli i konsideron faktet e çështjes të verifikuara siç janë treguar më lart (§§ 15-22).

B. Pohimi për shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ

Parashtresat e palëve

30. Ankuesja ankohet se procedurat gjyqësore për përcaktimin e atësisë ligjore për fëmijën e saj janë në pritje për shqyrtim nga viti 1993 dhe se gjykatat e Kosovës nuk kanë marrë vendim për padinë e saj. Ankuesja gjithashtu thekson se, disa herë, ajo ju kishte drejtuar gjykatave relevante në Kosovë dhe UNMIK-ut duke kërkuar përshpejtimin e shqyrtimit të rastit të saj; mirëpo, ajo nuk mori asnjë përgjigje. Ankuesja gjithashtu thekson se gjatë gjithë kësaj periudhe, ajo është dashur vet ta mbajë fëmijën e saj, me një ndihmë të kufizuar për mirëqenie sociale.

31. Sa i përket bazueshmërisë së ankesës, PSSP-ja thekson se në kohën kur rasti është referuar për rigjykim të kontestit të atësisë, në vitin 1998, UNMIK-u nuk kishte ardhur në Kosovë dhe prandaj nuk kishte asnjë përgjegjësi për administrimin e drejtësisë këtu. PSSP-ja përkujton se UNMIK-u kishte ardhur në qershor të vitit 1999 kur situata në Kosovë, duke përfshirë edhe sistemin e gjykatave, ishte "shumë e pasigurt dhe nuk kontrollohej nga asnjë institucion apo organ mbikëqyrës". Për këto arsye, ankesa është e pabazuar dhe do të refuzohet.

Vlerësimi i Panelit

32. E drejta për gjykim të drejtë, qasje në gjykatë dhe garancia për kohë të arsyeshme është e paparë në nenin 6 § 1 të KEDNJ, ku në pjesët relevante thuhet si vijon:

> "Në vendosjen e të drejtave civile dhe obligimeve […] secili ka të drejtë në dëgjim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar me ligj […]"

33. Paneli thekson se nuk është e kontestueshme se procedura gjyqësore që vendos për atësinë ligjore të fëmijës përfshin vendosjen e të drejtave civile dhe obligimeve në kuptim të nenit 6 të KEDNJ, dhe prandaj neni 6 zbatohet për rastin aktual.

34. Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut se e drejta për gjykim të drejtë e paparë në nenin 6 përfshin "të drejtën në gjykatë". Kjo e drejtë nënkuptohet jo vetëm si e drejtë për inicimin e procedurës pranë një gjykate për çështje civile, por edhe e drejtë për të marrë një vendim për kontestin nga gjykata. Në këtë aspekt, Gjykata Evropiane ka konstatuar se do të ishte zhgënjyese nëse sistemi ligjor vendor do t'i mundësonte individit të parashtrojë padi civile pranë një gjykate pa siguruar që rasti të vendoset me marrjen e një vendimi të formës së prerë në procedurën gjyqësore. Do të ishte e papërfytyrueshme për nenin 6 § 1 të përshkruaj në detaje garancitë procedurale që u jepen palëve ndërgjyqësore – se procedurat që janë të drejta, publike dhe të shpejta– pa u garantuar palëve se kontestet e tyre civile do të vendosen në formë të prerë (shih, në mesin e aktgjykimeve të tjera, GJEDNJ, *Multiplex kundër Kroacisë*, nr. 58112/00, aktgjykim i 10 korrikut 2003, § 45; GJEDNJ, *Kutiç kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, § 25, KEDNJ 2002-II; GJEDNJ, *Dubinskaya kundër Rusisë*, nr. 4856/03, aktgjykim i 13 korrikut 2006, § 41; shih gjithashtu PKDNJ, *Milogoriç dhe të Tjerët*, nr. 38/08 dhe të tjerët, mendim i 24 marsit 2011, § 35).

35. Mirëpo, Paneli gjithashtu thekson se kjo e drejtë nuk është absolute, por se mund t'u nënshtrohet kufizimeve; këto lejime janë të nënkuptuara meqë e drejta për qasje nga natyra e saj duhet të rregullohet nga autoritetet kompetente. Në këtë aspekt, autoritetet gëzojnë një shkallë të caktuar të diskrecionit. Mirëpo, kufizimet e zbatuara nuk duhet të kufizojnë apo të reduktojnë qasjen që i është mundësuar individit në atë mënyrë apo deri në atë shkallë sa të cenohet vet thelbi i së drejtës. Gjithashtu, kufizimi nuk do të jetë në pajtim me nenin 6 § 1 të KEDNJ nëse nuk e ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ka marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih GJEDNJ, *Stubbings dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i 22 tetorit 1996, Raporte të aktgjykimeve dhe vendimeve, 1996-IV, f. 1502, § 50; shih gjithashtu PKDNJ, *Milogoriç dhe të Tjerët*, cituar lart, § 44; *Berisha dhe të Tjerët*, nr. 27/08 dhe të tjerë, mendim i 23 shkurtit 2011, § 25; *Laliç dhe të Tjerët*, nr. 09/08 dhe të tjerë, mendim i 9 qershorit 2012, § 22).

36. Për sa i përket kohëzgjatjes së procedurës në veçanti, Paneli përkujton se KEDNJ u vë detyrë shteteve anëtare të organizojnë sistemin e tyre ligjor ashtu që gjykatave t'u lejojnë të përmbushin kushtet e nenit 6 § 1, duke përfshirë edhe kushtin e gjykimit brenda "kohës së arsyeshme" (shih GJEDNJ, Dhoma e lartë [DHL], *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*, nr. 25444/94, aktgjykim i 25 marsit 1999, § 74, KEDNJ 1999-II).

37. Paneli thekson se e drejta për gjykim të drejtë është e mbrojtur gjithashtu me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 10) dhe me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) (neni 14). Paneli thekson se instrumenti i fundit ishte ratifikuar nga ish Republika Socialiste e Jugosllavisë më 2 qershor 1971.

38. Duke u kthyer rrethanave të rastit aktual, Paneli thekson se ankuesja inicioi procedurë gjyqësore për vendosjen e atësisë së fëmijës së saj pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë në vitin 1993, dhe se padia e saj deri më sot akoma nuk është vendosur.

39. Paneli përkujton se sa i përket juridiksionit të tij kohor, sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai ka juridiksion për ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut "që kanë ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 apo që dalin nga faktet që kanë ndodhur para kësaj date kur faktet e tilla paraqesin shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Për rrjedhojë, Paneli ka kompetencë kohore (*ratione temporis*) për të vlerësuar përputhshmërinë e procedurës gjyqësore lidhur me padinë për përcaktimin e atësisë me nenin 6 të KEDNJ vetëm për periudhën pas 23 prillit 2005, derisa merr parasysh gjendjen e rastit në atë datë (shih PKDNJ, *Milogoriç dhe të Tjerët*, cituar në § 34 lart, në §§ 19-20).

40. Paneli thekson se procedurat gjyqësore të iniciuara nga ankuesja në vitin 1993 akoma ishin në pritje në momentin e ardhjes së UNMIK-ut në Kosovë në qershor të vitit 1999. Në veçanti, Paneli thekson se në atë kohë, urdhri për rigjykim i nxjerrë nga Gjykata Supreme e Serbisë në vitin 1998 akoma ishte në pritje. Paneli gjithashtu thekson se, meqë nuk ka dëshmi se është ndërmarrë ndonjë veprim nga gjykatat ndërmjet qershorit 1999 dhe 23 prillit 2005, kjo ishte gjendja në fillim të juridiksionit të Panelit, duke mos marrë vendim për padinë e ankueses. Periudha që është nën shqyrtim përfundon më 9 dhjetor 2008, kur EULEX-i merr përgjegjësinë në fushën e administrimit të drejtësisë (shih § 19 lart).

41. Në komentet e tij për bazueshmërinë e ankesës, PSSP-ja argumenton se UNMIK-u nuk mund të mbahet përgjegjës për dështimin e gjykatave të Kosovës në marrjen e një vendimi për padinë e ankueses. PSSP-ja argumenton se kur Gjykata Supreme ia referoi padinë për

përcaktimin e atësisë gjykatës komunale për rigjykim, UNMIK-u akoma nuk kishte ardhur në Kosovë dhe nuk kishte përgjegjësi për gjyqësorin në këtë vend. PSSP-ja gjithashtu argumenton se edhe në kohën e ardhjes së UNMIK-ut në vitin 1999, situata në Kosovë dhe gjendja në sektorin e drejtësisë ishin shumë të pasigurta dhe nuk kontrolloheshin nga asnjë institucion apo organ mbikëqyrës.

42. Në këtë aspekt, Paneli thekson se UNMIK-u kishte ardhur në Kosovë në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999, me mandatin, në mes tjerash,

> "të sigurojë një administrim të përkohshëm për Kosovën … duke themeluar dhe mbikëqyrur zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike të vetëqeverisjes për të siguruar kushtet për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës".

43. Shtrirja e mandatit të UNMIK-ut u sqarua edhe me Raportet e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të datës 12 qershor 1999 (S/1999/672) dhe 12 korrik 1999 (S/1999/672) drejtuar Këshillit të Sigurimit për implementimin e Rezolutës 1244 (1999). Në mënyrë specifike përfshin "organizimin dhe mbikëqyrjen e sistemit gjyqësor" dhe ushtrimin e "të gjitha kompetencave legjislative dhe ekzekutive, duke përfshirë edhe administrimin e gjyqësorit". Gjatë implementimit të mandatit të tij në territorin e Kosovës, duke përfshirë edhe rivendosjen e sundimit të ligjit, nga UNMIK-u u kërkua "të respektojë ligjet e Republikës së Jugosllavisë dhe të Serbisë" dhe "institucionet ekzistuese" për aq sa ato nuk ishin jokompatibil me standardet e të drejtave të njeriut të pranuara ndërkombëtarisht dhe me mandatin e UNMIK-ut sipas Rezolutës 1244 (1999). Nga UNMIK-u u kërkua gjithashtu "të promovojë të drejtat e njeriut në Kosovë", të udhëhiqet nga "standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si bazë për ushtrimin e autoritetit të vet në Kosovë" dhe të "miratojë politikat për të drejtat e njeriut lidhur me funksionet e veta administrative".

44. Për shkak të dështimit të administrimit të drejtësisë në Kosovë, dhe duke pranuar "nevojën urgjente për ndërtimin e sundimit të vërtetë të ligjit në Kosovë, duke përfshirë edhe përmes rivendosjes së menjëhershme të një gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe multi-etnik" (shih raportin e 12 korrikut 1999 § 66-67), UNMIK-u, në qershor të vitit 1999 themeloi Sistem emergjent të drejtësisë. Ky sistem i drejtësisë përbëhej nga një numër i kufizuar i gjyqtarëve dhe prokurorëve vendorë dhe ishte operacional derisa sistemi i rregullt i drejtësisë u bë funksional në janar të vitit 2000. Në janar të vitit 2003, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së, duke raportuar në Këshillin e Sigurimit për implementimin e Rezolutës 1244 (1999) e përkufizoi sistemin e drejtësisë në Kosovë në atë moment si sistem që "funksiononte mirë " dhe ishte "i qëndrueshëm".

45. Prandaj, Paneli konsideron se, edhe pse pa dyshim është e vërtetë se UNMIK-u akoma nuk ishte i pranishëm në Kosovë në vitin 1998 – kjo është koha kur ishte urdhëruar rigjykim – është gjithashtu e vërtetë se UNMIK-u u bë përgjegjës për administrimin e përkohshëm të Kosovës, duke përfshirë edhe administrimin e drejtësisë, nga 10 qershori 1999. Paneli po ashtu konsideron se, në pajtim me funksionet e veta ekzekutive dhe obligimet për të drejtat e njeriut, është legjitime të pritet që përpjekjet e UNMIK-ut për rivendosjen e sundimit të ligjit dhe organizimin e gjyqësorit në Kosovë, duhet gjithashtu të përfshijnë politikat për të siguruar realizimin e garancive për gjykim të drejtë, duk përfshirë edhe të drejtën e qasjes në gjykatë, për ata kontestet gjyqësore të të cilëve ishin në pritje për shqyrtim në kohën e ardhjes së UNMIK-ut.

46. Në këtë aspekt, Paneli i referohet parimit të vazhdimit të obligimeve të përfshirë në traktatet e të drejtave të njeriut, ashtu siç është vendosur nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (KDNJ) në kontekstin e obligimeve që dalin nga KNDCP dhe të cilës i referohet Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, se të drejtat fundamentale që mbrohen nga traktatet ndërkombëtare u përkasin popujve të cilët jetojnë në territorin e palës shtet në fjalë. Në veçanti, KDNJ ka theksuar se "pasi popullit t'i ofrohet mbrojtja e të drejtave sipas Konventës, mbrojtja e tillë bartet me territorin dhe vazhdon t'u përkasë atyre, pavarësisht ndryshimeve në qeverinë e palës shtet, duke përfshirë edhe ndarjen në më shumë se një shtet ose shtetin pasardhës" (shih KDNJ, Komenti i përgjithshëm nr. 26: Vazhdimi i obligimeve, 8 dhjetor 1997, KDCP/C/21/Rev.1/Add.8/Rev.1, § 4; shih gjithashtu, përshtatshmërish (*mutatis mutandis)*, GJEDNJ, *Bijeliç kundër Malit të Zi dhe Serbisë*, nr. 11890/05, aktgjykim i 28 prillit 2009, §§ 58 dhe 69).

47. Paneli thekson se në rastin aktual nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim nga UNMIK-u për të siguruar që kërkesa e ankueses që ishte në pritje pranë sistemit gjyqësor të Kosovës në kohën e ardhjes së UNMIK-ut të shqyrtohet nga autoritetet kompetente. Në fakt, kërkesa e tillë është akoma e regjistruar dhe në pritje në sistemin e drejtësisë në Kosovë deri më sot.

48. Paneli po ashtu thekson se, përveç supozimit se dosja është humbur gjatë konfliktit të vitit 1998-1999 në Kosovë, që është hedhur poshtë nga Paneli, UNMIK-u nuk ka dhënë ndonjë sqarim pse kërkesa e ankueses nuk ishte proceduar nga gjykatat. Paneli po ashtu thekson se UNMIK-u nuk ka dhënë asnjë sqarim nëse është zhvilluar ndonjë politikë nga UNMIK-u për sistemin e përkohshëm për të siguruar trajtimin e rasteve tanimë në pritje në gjykatat e Kosovës para ardhjes së tij. Duket se rastet e tilla ishin lënë në pritje meqë ata as nuk ishin hedhur poshtë formalisht as nuk ishin vendosur, siç ishte rasti i ankueses.

49. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, Paneli konstaton se është shkelur e drejta e ankueses për qasje në gjykatë e paraparë në nenin 6 të KEDNJ.

50. Paneli thekson se pohimet e ankueses se procedurat gjyqësore lidhur me kërkesën për përcaktimin e atësisë nuk ishin përfunduar brenda një kohe të arsyeshme ngrenë çështjet e njëjta si ato të shqyrtuara më lart nën të drejtën e qasjes në gjykatë.

51. Për këtë arsye, Paneli konstaton se nuk është e nevojshme të shqyrtojë çështjen e kohëzgjatjes së procedurës.

C. Pohimi për shkelje të nenit 13 të KEDNJ

52. Paneli konstaton se ankesa sipas nenit 13 të KEDNJ (e drejta për mjet të efektshëm) në esencë kanë të bëjnë me çështjet e njëjta sikurse ato të diskutuara në nenin 6 § 1. Në këto rrethana, Paneli konstaton se nuk ngritën çështje të ndara sipas nenit 13 të KEDNJ (shih PKDNJ, *Milogoriç dhe të Tjerët*, cituar në § 34 lart, në § 49).

V. REKOMANDIMET

53. Duke marrë parasysh të gjeturat e Panelit në këtë rast, Paneli është i mendimit se ndonjë formë e reparacionit është e nevojshme.

54. UNMIK-u normalisht është ai i cili duhet të ndërmerr hapat e duhur për t'i dhënë fund shkeljes së theksuar dhe për të kompensuar efektet e saj sa më shumë që të jetë e mundur. Mirëpo, siç theksoi Paneli lart (shih § 19) përgjegjësia e UNMIK-ut sa i përket gjyqësorit në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008, me marrjen e kontrollit të plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit nga EULEX-i. Prandaj, UNMIK-u nuk është më në pozicion të ndërmerr masa që do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në procedurat që janë në pritje pranë gjykatave komunale.

55. Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi për të kompensuar sa më shumë që të jetë e mundur efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës. Në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta e Njeriut në situatat e juridiksionit të zvogëluar të shtetit, Paneli është i mendimit se UNMIK-u duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike që i ka në dispozicion vis-à-vis autoriteteve të Kosovës, për të marrë garanci se lënda e parashtruar nga ankuesja do të procedohet me kohë (shih GJEDNJ [DHL], *Ilaşcu dhe të Tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 48787/99, aktgjykim i 8 korrikut 2004, § 333, KEDNJ 2004-VII; GJEDNJ, *Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, aktgjykim i 2 marsit 2010, § 171, KEDNJ 2010 (fragmente); GJEDNJ [DHL], *Catan dhe të Tjerët kundër Republikës së Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 43370/04 dhe të tjerë, aktgjykim i 19 tetorit 2012, § 109; shih gjithashtu PKDNJ, *Milogoriç dhe të Tjerët*, cituar në § 34 lart, në § 49).

56. Paneli gjithashtu konsideron se UNMIK-u duhet të ndërmarrë hapa përkatës për kompensimin adekuat të ankueses për dëmet jomonetare, të cilat ajo i ka pësuar si rezultat i ndalimit të zgjatur të procedurës të iniciuar nga ajo.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

1. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME TË DREJTËN PËR QASEJ NË GJYKATË;**

2. **KONSTATON SE NUK ËSHTË E NEVOJSHME TË SHQYRTOHET ANKESA SIPAS NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME KOHËZGJATJEN E PROCEDURËS;**

3. **KONSTATON SE NUK ËSHTË E NEVOJSHME TË SHQYRTOHET ANKESA SIPAS NENIT 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT.**

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar